



An EU funded project managed by the  
European Union Office in Kosovo



Qendra Kosovare për Studime Gjinore  
Kosovar Gender Studies Center



# ***“Integrimi gjinor përmes procesit të Integrimit Evropian”***

Prishtinë, 2016



SWEDEN



Kvinna till Kvinna

This material is financed by Swedish International Development Cooperation Agency (Sida) and Kvinna till Kvinna.

*“Integrimi gjinor përmes  
procesit të Integrimit Evropian”*

Botues: Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ)

Hartuar nga: AnketaCo

Dizajni: ASHA graphics

**QKSGJ** [www.kgscenter.net](http://www.kgscenter.net)

Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) është organizatë e përqendruar në çështje gjinore. Gjatë 14 viteve të ekzistencës së vet, organizata i ka kontribuar integrimit gjinor dhe ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të arritur barazinë gjinore në Kosovë.

Misioni i Qendrës Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) është integrimi i perspektivës gjinore në të gjitha analizat, programet dhe politikat e të gjithë sektorëve të shoqërisë kosovare, përmes ngritjes së vetëdijes për çështje gjinore, zhvillimit të studimeve gjinore, krijimit të politikave të ndjeshme nga aspekti gjinor përmes hulumtimeve, zhvillimit të politikave, avokimit dhe lobimit.

**Adresa:**

Rr. Nëna Terezë Nr. 18/1

10000 Prishtinë, Kosovë

Tel. +381 (0) 38 735 991

***“Integrimi gjinor përmes  
procesit të Integrimit Evropian”***

Prishtinë, 2016

**Mohim përgjegjësie**

*Ky botim është hartuar me ndihmën e Bashkimit Evropian, Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida) dhe Kvinna till Kvinna. Përmajtja e këtij publikimi është në përgjegjësi të vetme të QKSGJ dhe në asnjë mënyrë nuk mund të shihet si pasqyrim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian, Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida) dhe Kvinna till Kvinna.*

**Të drejtat autoriale**

© Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), 2016. Të gjitha drejtat e rezervuara.

# PËRMBAJTJA

<b>Përmbledhje ekzekutive .....</b>	<b>2</b>
<b>1. Sfondi .....</b>	<b>4</b>
1,1. Sfondi i Projektit .....	4
1,2. Sfondi i Hulumtimit .....	4
<b>2. Metodologjia .....</b>	<b>4</b>
<b>3. Të gjeturat kryesore .....</b>	<b>6</b>
3,1. Komuna e Dragashit .....	6
3,2. Komuna e Malishevës .....	9
3,3. Komuna e Prizrenit .....	11
3,4. Komuna e Rahovecit .....	13
3,5. Komuna e Suharekës .....	15
<b>4. Konkluzionet dhe Rekomandimet .....</b>	<b>17</b>
<b>Aneksi 1: Udhëzimet për DFG .....</b>	<b>19</b>



## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

**K**y raport është hartuar nga AnketaCo si produkt i fundit i hulumtimit të realizuar në emër të QKSGJ-së në komunat e regjionit të Prizrenit. Hulumtimi, i cili është lëndë e këtij reporti, është pjesë e aktiviteteve të realizuar me ndihmën e Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida) dhe Kvinna till Kvinna. Është gjithashtu pjesë e një kuadri më të gjerë të aktiviteteve të realizuar nga QKSGJ-ja dhe organizatat e saj partnere në regjionin e Prizrenit (Dora-Dorës) përmes projektit “Barazia dhe integrimi gjinor përtej kufijve”, projekt ky i financuar nga skema e bashkëpunimit tej-kufitar të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë. Pikësynimi kryesor i hulumtimit ishte të përcaktojë njohuritë lokale mbi procesin e integritimit në BE si dhe për integrimin gjinor, si një koncept gjithëpërfshirës për të gjitha politikatat. AnketaCo beson se të gjeturat e kësaj ankete do të përfshihen në debatin mbi politikatat dhe QKSGJ-ja dhe partnerët e saj do t’i përdorin për të planifikuar intervenime pasuese në regjionin e mbuluar nga projekti.

Metodologjia e aplikuar për të zbatuar hulumtimin përbëhet nga metodat kualitative, ku janë të përfshirë intervistat e gjithanshme me informues kyç, shqyrtimi i materialeve primare dhe sekondare, si dhe diskutimet në fokus grupe me audiencën parësore - gratë dhe organizatat e grave në regjionin e Prizrenit. Intervistat me informues kyç janë kryer duke zbatuar Udhëzuesin për intervista, i cili ofron një listë të propozuar të temave dhe pyetje të gjera të cilat duhet të shtjellohen në intervistë (bazuar në sfondin e të anketuarit). Në shqyrtimin e materialeve relevante gjithashtu është përfshirë shqyrtimi i dokumenteve komunale, raporteve dhe materialeve të hartuar nga organizatat tjera, artikujt në media, si dhe dokumentet e tjera ligjore dhe të politikave në nivel vendi. Diskutimet me fokus grupet (DFG) janë kryer në secilën komunë të regjionit të Prizrenit dhe në secilin prej tyre morën pjesë 8-10 gra. DFG-të u administruan nga një moderator në bazë të Udhëzimeve për DFG, të cilat ofrojnë një skicë të temave të cilat duhet të diskutohen në grup. DFG-të u regjistruan për qëllime të sigurimit të cilësisë.



Hulumtimi për integrimin gjinor përmes integritit të BE-së shpalos disa aspekte të rëndësishme të cilat QKSGJ-ja dëshiron t'i vë në pah. Pikë së pari, është një mungesë e njohurive si nga gratë ashtu edhe nga organizatat e grave, por edhe nga zyrtarët komunal përkitazi me rrjedhën e procesit të integritit në BE dhe çfarë mundësish krijon ai për integrimin e gjinisë. Ekziston një mungesë e përgjithshme e njohurive lidhur me instrumentet që i ofron BE-ja për avancimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi, dhe integrimin gjinor në veçanti. Hulumtimi gjithashtu vuri në pah se shumica e grave dhe organizatave të grave të përfshira në hulumtim nuk janë shumë të njoftuar me konceptet e integritit gjinor, planifikimit dhe buxhetimit me ndjeshmëri gjinore si dhe qasjeve të ngjashme për integrimin gjinor si aspekt i ndërthurur i të gjitha politikave. Njohuritë për procesin e integritit në BE dhe integrimin gjinor janë gjithashtu të mangëta tek autoritetet lokale, të cilat përveç një Zyrtari për barazi gjinore (dhe ndonjëherë një buxheti të vogël për "projekte të grave"), nuk posedojnë njohuri të duhur për integrimin gjinor apo edhe interesim për të vënë në zbatim instrumente të integritit gjinor. Rrjedhimisht, kuota prej 50% e paraparë me Ligjin për barazi gjinore, e cila duhet të rezervohet për gratë në administratë publike në të gjitha nivelet, nuk respektohet. Kjo është posaçërisht e vërtetë në pozitat vendim-marrëse të nivelit të lartë.

Disa nga barrierat dhe kufizimet më të mëdha për barazinë gjinore dhe për futjen e mekanizmave për përmirësim të barazisë gjinore përmes integritit në BE të cilat u identifikuan nga të anketuarit/pjesëmarrësit nga regjioni i Prizrenit janë:

- Shkollimi i grave
- Normat kulturore/shoqërore dhe animi gjinor.
- Të drejtat pronësore dhe zbatimi i ligjit për trashëgimi.
- Punësimi i grave dhe zbatimi i Ligjit për barazinë gjinore

Në një mjedis të këtillë, ekipi fuqishëm rekomandon që të bëhen përpjekje serioze për të edukuar audiencat cak lidhur me mundësitë që ofrohen nga procesi i integritit në BE, rrjedhën e përgjithshme të tij si dhe cilat procese specifike do të realizohen në secilën fazë të integritit. Pa njohuri të njëmendtë të proceseve të integritit dhe instrumenteve që i ofron ky proces, gratë dhe organizatat e grave nuk mund ta shfrytëzojnë procesin në mënyrë efektive për të avancuar gjendjen e grave në vend.

Natyra e integrimit në BE është e tillë që procesi përmes të cilit futen ndryshimet është po aq i rëndësishëm sa edhe vetë rezultati/ndryshimi përfundimtar. Rëndësia e Instrumentit Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR) dhe mekanizmeve të tjerë civil të financimit si dhe rëndësia e kontributeve të rregullta për Raportin e Progresit të KE-së, duhet të avokohen fuqishëm në mesin e grave dhe organizatave të grave. Në skenarin e Kosovës, dhe në veçanti në raport me integrimin gjinor, avokimi përmes raportit të progresit të KE-së, është dëshmuar si një mënyrë shumë efektive për të avancuar agjendën e barazisë gjinore. Me përfshirjen në raport, automatikisht bëhet obligim për Qeverinë e Kosovës, për të cilin ata duhet të raportojnë në periudhat e ardhshme të raportimit.

Duke pasur parasysh mungesën e njohurisë lidhur me temat siç janë buxhetimi gjinor dhe planifikimi me ndjeshmëri gjinore të politikave dhe ligjeve, ekziston nevojë imediate që të hartohen shabllone, vegla, doracakë shpjegues, si dhe të mbahen trajnime të zyrtarëve përgjegjës lidhur me zbatimin e këtyre veglave. Përpjekjet dhe aktivitetet e mëhershme kanë prodhuar dëshmi se mënyra më efektive për ta shtyrë përpara agjendën e barazisë gjinore është me krijimin e storjeve të suksesit, të cilat pastaj mund të pasohen edhe në vendet tjera në tërë vendin. Prandaj, këshillohet që të realizohet, në formë piloti, proces i buxhetimit gjinor me komunat përfituese dhe me këtë të ofrohet një shembull të cilin do ta ndjekin të tjerët.

# 1. SFONDI

## 1.1. Sfondi i projektit

Projekti **“Promovimi i barazisë gjinore përmes integritit gjinor”**, i mbështetur nga *Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida) dhe Kvinna till Kvinna* ka si pikësynim të përgjithshëm të projektit: Të përmirësojë integritin gjinor, dhe të përfshijë çështjet gjinore si një çështje e ndërthurur në procesin e integritit në BE dhe planifikimin e programeve të BE-së në Kosovë, si dhe në dokumentet strategjike dhe zhvillimore kombëtare të Kosovës.

Duke ndërfutur terminologjinë e ndjeshme ndaj gjinisë dhe planifikimin e ndjeshëm ndaj gjinisë në procesin e integritit në BE dhe në shpërndarjen e fondeve të BE-së në Kosovë, projekti synon gjithashtu të kanalizojë mbështetje financiare për prioritetet e grave dhe sfidave me të cilat ata ballafaqohen. Për më tepër, duke ndërfutur gjininë si temë që nga fillimi i procesit të planifikimit të BE-së, siguron që ky aspekt do të ndiqet në të gjitha fazat e ardhshme.

Projekti **“Barazia dhe integrimi gjinor përtej kufijve”** ka filluar së zbatuari në tetor 2014, mbështetur nga *BE-ja në kuadër të bashkëpunimit tejkuftar* në IPA ndërmjet Kosovës dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë (IRJM). Pikësynimi i veprimit është të themelojë një rrjet tej-kufitar të organizatave të grave, që janë aktive në integritin gjinor në nivel lokal dhe rajonal, duke fuqizuar OJQ-të lokale për të avancuar agjendën e integritit gjinor, ngritjen e kapaciteteve të organizatave lokale të grave në zonën e projektit, ofrimin e ndihmës teknike për ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse dhe përmirësimin e mbulueshmërisë së temave të ndërlidhura me gratë në mediat lokale dhe kombëtare.

## 1.2. Sfondi i Hulumtimit

Lënda e hulumtimit të këtij raporti është miratuar nga QKSGJ me qëllim që të fitohet një kuadro më e qartë të kësaj çështjeje, si dhe t'u ofrohet organizatave të shoqërisë civile argumente të forta për të avokuar me sukses për çështjet që kanë të bëjnë me provimin e barazisë gjinore në nivel të BE-së. Hulumtimi është kryer në periudhën prill - korrik 2016, ndërsa raportimi dhe prezantimi i raportit u kompletua në periudhën gusht - shtator. Si pjesë e kontratës, AnketaCo ishte përgjegjëse për të dizajnuar dhe zbatuar hulumtimin për "Promovimin e barazisë gjinore në integritet në BE", i cili u zbatua në bashkëpunim të ngushtë me QKSGJ dhe partnerët e saj nga regjioni i Prizrenit.

Studimi gjithashtu kishte për qëllim të shërbejë si një skicë për OJQ-të lokale të grave dhe t'i pajisë me një vizion strategjik, dhe pozicionim më të mirë në procesin e integrimit në BE si dhe ta shfrytëzojnë procesin për të avancuar agjendën e të drejtave të grave. Rrjedhimisht, pritjet nga hulumtimi gjithashtu kishin të bënin me ofrimin e informatave dhe rekomandimeve të cilat iu përgjigjen nevojave specifike të grave, si dhe udhëzime për të shtjelluar çështje me prioritet më të lartë në promovimin e barazisë gjinore në nivel të BE-së.

## 2. METODOLOGJIA

**D**uke pasur parasysh pikësynimet e lartcekura të hulumtimit, metodologjia më optimale për të mbledhur të gjitha të dhënat e kërkuara nga QKSGJ erdhi në formën e qasjes kualitative, përmes të cilës, hulumtimi u krye përmes instrumenteve kualitative, gjegjësisht, shqyrtimit sekondar të literaturës, intervistat e gjithanshme me informues kyç dhe diskutime në fokus grupe. Instrumentet janë dizajnuar për të reflektuar dijen e pritur të audiencës cak dhe gjendjes specifike të këtyre grupeve cak.

Mostra e të anketuarve për DFG është përbërë nga 47 pjesëmarrës nga audienca cak. Konkretisht, mostra është zbërthyer në mënyrë gjeografike ku janë përfshirë një komunë për një DFG dhe 6-10 pjesëmarrës për secilën komunë. Komunitat e përfshirë në hulumtim janë ato të regjionit të Prizrenit, gjegjësisht:

- Komunën e Prizrenit
- Komunën e Suharekës
- Komunën e Rahovecit
- Komunën e Dragashit
- Komunën e Malishevës

Përzgjedhja e të anketuarve është bërë në bashkëpunim me QKSGJ dhe organizatat e saj partnere në regjionin e Prizrenit. Mostra e pjesëmarrësve në DFG përfshinte pjesëtarë të OSHC-ve dhe gra aktiviste, por gjithashtu edhe zyrtarë për barazi gjinore në komunitat e përzgjedhura.

Mostra për Intervistat e gjithanshme me informues kyç ishte shtatë persona. Mostra u konsiderua e mjaftueshme për të mbuluar hisedarë më të rëndësishëm dhe të informuar, përfshirë këtu OJQ lokale dhe ndërkombëtare, institucione të nivelit qendror, dhe autoritetet komunale.

Metoda e aplikuar për përzgjedhjen e mostrës së popullsisë cak të Informatorëve kyç për intervistat e gjithanshme ishte ajo ortekut. Duke aplikuar këtë teknikë, AnketaCo, në bashkëpunim me QKSGJ-në, identifikoi dy të anketuar parësorë. Secilit të anketuar i është kërkuar që të sugjerojnë dy të anketuar të tjerë. 7 të anketuar të cilët kanë marrë numrin më të madh të referimeve janë përzgjedhur për intervistë. Duke aplikuar metodën e ortekut, ekipi i AnketaCo mënjanoi të gjitha njëanshmëritë në përzgjedhjen e të anketuarve, prandaj edhe patën ndikim minimal në rezultat. Për më tepër, kjo metodë gjithashtu mundëson identifikimin adekuat i subjekteve më aktive dhe të rëndësishme, dhe kjo sipas mendimit të vetë hisedarëve.

Pas realizimit të DFG dhe intervistave të gjithanshme, AnketaCo vazhdoi me hartimin e raportit të të gjeturave (këtij dokumenti). Raporti i të gjeturave iu prezantua një grupi të zgjedhur të organizatave të shoqërisë civile nga regjioni i Prizrenit dhe rezultatet dhe rekomandimet u diskutuan me ata në një tryezë të rrumbullakët. Ky hap është dizajnuar të sigurojë kontribute të fundit për raportin e hulumtimit, duke rritur kështu edhe më tej natyrën reprezentative të raportit lidhur me mendimet dhe perceptimet e audiencës cak.

### 3. TË GJETURAT KRYESORE

**D**uket se ekziston një njohuri e përgjithshme sesi mund të lehtësohet integrimi gjinor në praktikë, edhe pse ka njëfarë njohurie se çka është në fakt integrimi gjinor. Në disa raste, edhe vetë koncepti i integritit gjinor kuptohet në mënyrë mjaft të mjegullt, duke e pamundësuar kështu edhe më tej kontributin në procesin e integritit të BE-së. Edhe pse disa pjesëmarrës ofruan përgjigje mjaft të kompletuara përkitazi me atë se çka nënkupton integrimi gjinor, shpesh ideja e integritit konceptohet gabimisht dhe/ose është e kufizuar apo e marginalizuar.

Përkitazi me procesin e integritit në BE, pjesëmarrësit në përgjithësi nuk mund t'i elaborojnë hapat/fazat e ardhshme dhe çka duhet të bëjë Kosova në secilën prej tyre. Pa një njohuri të përgjithshme të procesit dhe veglave në dispozicion për të integruar gjininë përmes këtij procesi, mund të pritet pak përparim për përmirësimin e barazisë gjinore nga procesi i integritit në BE. Organizatave të grave dhe grave aktiviste duhet t'u ofrohet trajnim për procesin e integritit, instrumentet në dispozicion për agjendën e integritit gjinor.

Për më tepër, duhet të vihen në zbatim shabllonet adekuate, doracakët, politikat dhe mjetet tjera praktike dhe komunave duhet t'u ofrohet ndihmë në përdorimin e tyre. Në vijim janë prezantuar më hollësisht të gjeturat për komunat e veçanta. Aktivitete pilot të buxhetimit të ndjeshëm gjinor dhe planifikimit të ndjeshëm gjinor të politikave duhet të zbatohen në komuna dhe institucione të nivelit qendror, të cilat janë më të gatshme t'i vënë në zbatim ndryshimet e tilla në ciklet e tyre të planifikimit dhe të politikave.

### 3.1. Komuna e Dragashit

Diskutimi në fokus grupe në Dragash u mbajt më 20 prill 2016, me fillim në ora 13:00, ku ishin të pranishëm gjithsej shtatë pjesëmarrës. Shtjellimi i temave filloi me diskutimin për integrimin e gjinisë si koncept dhe çka nënkuptojnë pjesëmarrësit me këtë. Për këtë qëllim, pjesëmarrësit ofruan vështrime mjaft të sakta, duke e definuar gjerësisht si gëzim i të drejtave të barabarta për të gjithë në të gjitha lëmitë e jetës, dhe barazia gjinore si pjesë përbërëse e të gjitha politikave. Njohuritë e tilla për integrim gjinor, edhe pse shprehur në mënyrë mjaft të thjeshtëzuar, kjo dije mjafton të mobilizojmë resurset lokale për të avancuar agjendën e integritimit gjinor në nivel lokal.

Pas përkufizimit të integritimit gjinor, diskutimi u orientua në pengesa dhe sfida për barazi dhe integrim gjinor. Për këtë qëllim, pjesëmarrësit vunë në pah disa çështje, të cilat në përgjithësi mund të grupohen në sfida kulturore dhe shoqëro-ekonomike për barazinë e plotë ndërmjet gjinive. Përbrenda grupit të faktorëve kulturore, të cilat pengojnë barazinë e grave me meshkujt, u diskutuan aspekte të shumta me pjesëmarrësit e komunës së Dragashit.

Mentaliteti i prapambetur konsiderohet si një pengesë më e madhe për të tejkaluar për arritjen e harmonisë gjinore në Dragash. Pjesëmarrësit në DFG, teksa i vënë në dukje të arriturat që nga viti 1999 e këndeje, sipas mendimit të tyre, mbetet edhe shumë punë për t'u bërë për t'u tejkaluar pengesat kulturore, të cilat pengojnë integrimin gjinor.

Dragashi kualifikohet nga pjesëmarrësit në DGF si një prej regjioneve më konzervative, madje edhe përbrenda realitetit të Kosovës. Edhe pse ka ndryshime të dukshme që nga hapja e universitetit të Prizrenit, gjendja e grave në këtë komunë vazhdon të jetë sfiduese. Mentaliteti është arsye parësore që gratë vazhdojnë të heqin dorë nga të drejtat e tyre trashëgimore në dobi të vëllezërve të tyre. Tema e ndarjes së barabartë të trashëgimisë në mesin e meshkujve dhe grave ende konsiderohet si një temë tabu dhe në përgjithësi shihet me ngurrim. Shpresa për ndryshim të mentaliteti qëndron tek të rinjtë në rend të parë, pasi që nuk është shumë reale që gjeneratat e vjetra të jenë në gjendje ta transformojnë dhe të përvetësojnë qëndrime më përparimtare lidhur me barazinë ndërmjet gjinive.



Diskriminimi në të drejta të trashëgimisë ndaj grave gjithashtu është vërejtur si një faktor shoqëroro-ekonomik i cili prek gratë në mënyrë të dëmshme. Përderisa brenda komunitetit shqiptar të komunës së Dragashit, gratë rrallë i kërkojnë të drejtat në trashëgimi të pronës së përbashkët, gjendja ndryshon në komunitetin goran, ku gratë shpesh i kërkojnë të drejtat në trashëgimi të tillë. Pa pronë, gratë kanë mundësi shumë më të kufizuara për zhvillim personal dhe profesional, për krijim të të hyrave dhe për të vendosur për vete. Gjendja vazhdon e njëjtë edhe në jetën e tyre martesore, ku në masë të madhe bëhen të varur nga bashkëshortët e tyre.

Arsimimi konsiderohet si një përbërës i dytë kyç për avancimin e suksesshëm të të drejtave të grave dhe agjendës së barazisë gjinore. Shkollimi gjithashtu shihet si një prej katalizatorëve kyç për të ndikuar në mënyrë pozitive bindjet dhe mentalitetin, i cili konsiderohet si një pengesë e madhe. Duke iu referuar ndikimit pozitiv që kishte hapja e Universitetit të Prizrenit për rritjen e numrit të të rejave të cilat vijojnë shkollim të lartë, gratë në DFG në Dragash vunë në pah edhe rëndësinë e shkollimit të barabartë të djemve dhe vajzave në të ardhmen. Shkollimi i ulët u pa si shkak kryesor për vështirësitë në arritjen e kuotës prej 50% për gratë, posaçërisht në nivele vendim-marrëse. Sipas mendimit të pjesëmarrësve, nevojitet avokim në emër të vajzave të reja të cilat përfundojnë shkollim të lartë, në mënyrë që ta avancojnë gjendjen e grave në Kosovë.

Martesat e hershme janë edhe një çështje tjetër e cilësuar si shumë e rëndësishme gjatë diskutimit në komunën e Dragashit. Martesat e hershme të cilat shpesh motivohen nga gjendja e dobët ekonomike dhe synojnë të krijojnë jetesë më të mirë jashtë vendit, prekin në mënyrë shumë negative këtë regjion. Janë regjistruar raste të shumta të martesave të hershme, posaçërisht në mesin e komunitetit të goranëve, ku vajzat fejohen që në moshën 14-15 vjeçare. Mentaliteti i prapambetur, ku gratë shihen si objekte dhe sjellja e pranueshme për gratë dhe meshkujt bazohen në një standard të dyfishtë dhe mungesë të mundësive dhe shpresës për jetë më të mirë, i kanë kontribuar vazhdimisht të kësaj dukurie.

Gjendja e punësimit të grave në komunën e Dragashit është shumë e pakënaqshme, dhe janë duke u ndërmarrë hapa për përfshirje më të madhe të grave. Punësimi në sektorin publik mbetet çështje problematike, ku nga

115 të punësuar në administratën komunale, vetëm 13 janë gra. Kombinimi i gatishmërisë për të zbatuar Ligjin për barazinë gjinore dhe mungesë e kuadrove të kualifikuara të grave, krijojnë një gjendje shqetësuese të pjesëmarrjes së grave në vendim-marrje.

Punësimi në sektorin privat është gjithashtu problematik. Në këtë aspekt, norma përgjithësisht e ulët e zhvillimit ekonomik e pranishme në komunë ndikon tek gratë në mënyrë negative. Punësimi i paktë në regjion i vë gratë në pozitë jo të favorshme, pasi që nga aspekti kulturor, nuk është e pranueshme që ata të punojnë para bashkëshortëve dhe/ose vëllezërve të tyre. "Përshtatshmëria kulturore" gjithashtu është një pengesë e cila ngushton më tej mundësitë për gratë për gjetjen e punësimit dhe shumë pozita në sektorin privat konsiderohen si të papërshtatshme për gratë. Mungesa e kopshtit të fëmijëve në komunë gjithashtu shihet si një faktor pengues për punësimin e grave. Në mungesë të një institucioni publik, ku nënat e punësuar do t'i dërgonin fëmijët gjatë orarit të punës, punësimi i grave kushtëzohet me gatishmërinë e familjeve të tyre për t'u kujdesur për fëmijë.

Gratë në politikë dhe institucione publike janë marginalizuar në masë të madhe. Përbrenda partive politike, gratë janë të marginalizuara në forumet e grave, dhe nuk pritet që të shtjellojnë çështje të politikës së lartë, të cilat janë të rezervuara për meshkujt. Madje edhe në kuvendin komunal, ku gratë përfaqësohen me 30% të anëtarëve, gratë rrallë kyçen në diskutim. Ato asnjëherë nuk e afirmojnë agjendën e barazisë gjinore apo të drejtat e grave në komunë. Rrjedhimisht, nuk kanë mbledhur mbështetjen e grave votuese dhe në përgjithësi, edhe vetë gratë nuk i votojnë gratë në Dragash.

Në lidhje me procesin e integrimit në BE dhe njohuritë e përgjithshme të pjesëmarrësve lidhur me këtë proces, mendimet duket se nuk janë plotësisht të sakta. Ekziston mungesë e përgjithshme e njohurive lidhur me procesin e integrimit dhe pritet nga procesi duket të jenë krijuar kryesisht rreth qasjes së BE-së në Kosovë. Pjesëmarrëset në DFG në Dragash konsiderohet se procesi i integrimit në BE ka të bëjë me bashkësitë minoritare në rend të parë, dhe komentet e para për këtë temë kishin të bënin me gjendjen e mirë të komuniteteve pakicë në këtë komunë. Në përgjithësi, ka mungesë të mekanizmave dhe mjeteve në dispozicion për integrim të gjinisë dhe të drejtave të grave përmes procesit të integrimit në BE.

Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit shihet si shumë i rëndësishëm për të avancuar agjendën e barazisë gjinore në Dragash. Për këtë qëllim, zbatimi i Ligjit për barazi gjinore dhe legjislacionit tjetër të ndërlidhur me gjininë (gjegjesisht, dispozitat e ligjit të punës që kanë të bëjnë me lehoninë), do të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejt dhe imediate gratë dhe barazinë e gjinive në Dragash.

Në përgjithësi, mbizotëron mendimi se për të arritur barazinë gjinore, gratë duhet të kenë guximin që t'i kërkojnë të drejtat e veta dhe se sukcesi varet në masë të madhe nga vendosmëria e tyre për t'i kërkuar këto të drejta. Gjithashtu, në përgjithësi mendohet se ekziston një nevojë e madhe e rritjes së vetëdijes së meshkujve dhe grave, me fokus të veçantë tek të rinjtë, me të cilët duhet të punohet për t'i bërë ndryshimet e duhura në të ardhmen.

### **3.2. Komuna e Malishevës**

Diskutimi në fokus grupe në Malishevë u mbajt më 18 prill 2016, me fillim në ora 10:00, ku ishin të pranishme gjithsej tetë përfaqësuese të organizatave të grave. Diskutimi në grupe filloi me konceptin e Integritit gjinor, ku pas shpjegimit të shkurtër të rregullave të DFG, pjesëmarrësit u ftuan të diskutojnë. Në këtë aspekt, pjesëmarrësit shfaqën njohuri mjaft të kufizuara për nga fushëveprimi, dhe thanë se ka të bëjë me të drejta të barabarta përbrenda departamenteve të komunës. Pjesëmarrësit besojnë se komuna e Malishevës ka shënuar përparim të dukshëm kah integrimi gjinor, por duhet të bëhen përpjekje të konsiderueshme për të arritur barazinë ndërmjet meshkujve dhe grave në komunë.

Kur diskutohen sfidat kulturore për barazinë e plotë gjinore në shoqëri, pjesëmarrësit së pari cekin çështjen e trashëgimisë së pronës. Besohet se kjo çështje ndikon në mënyrë negative te gratë dhe është një prej çështjeve më të rëndësishme për arritjen e barazisë gjinore. Sipas mendimit të pjesëmarrëseve të DFG në Malishevë, kjo çështje kërkon vëmendje të veçantë, si të institucioneve ashtu edhe të shoqërisë civile. Edhe pse pranojnë se çështjet e trashëgimisë janë problematike për tërë Kosovën, pjesëmarrësit në Malishevë konsiderojnë se, duke qenë se janë kryesisht komunë rurale, përmasat e problemit bëhen më të mëdha. Në vendin ku pjesa më e madhe e tokës është tokë bujqësore (zakonisht e rrethuar me

tokë të familjeve të tjera), është e vështirë që gratë t'i gëzojnë të drejtat në shfrytëzim të tokës në rastet kur ligjërisht mund ta kërkojnë.

Pjesëmarrësit nga Malisheva gjithashtu vënë në dukje ndryshimet pozitive të arritura pas luftës në lidhje me barazinë gjinore. Në lëminë e arsimit dhe punësimit ka pasur më shumë ndryshime pozitive krahasuar me sektorë të tjerë ku duhet të ndodh integrimi i gjinisë. Pjesëmarrësit vunë në pah që disa gra janë drejtorë të departamenteve në komunë, por pranojnë se janë larg zbatimit të kuotës prej 50% përfaqësim të rezervuar për gra, në veçanti në nivelet vendim-marrëse.

Lloji i dytë i kufizimeve - ato që kanë të bëjnë me aspekte shoqëro-ekonomike të cilat përfaqësojnë sfida strukturore për barazinë gjinore, pjesëmarrësit në DFG në Malishevë së pari vunë në dukje standardin e dyfishtë kundrejt meshkujve dhe grave në lidhje me arsimin dhe punësimin. Edhe pse pohojnë se gjendja është përmirësuar dukshëm, në veçanti në lidhje me arsimin, pjesëmarrësit nga Malisheva theksojnë edhe çështje të vetëdijesimit lidhur me rëndësinë e arsimimit për gratë. Kjo konsiderohet nga pjesëmarrësit si vendim që merret në nivel të familjes, dhe konsiderojnë se intervenimet duhet të shtjellojnë pikërisht këtë këndvështrim. Mospërputhjet në arsim shihen si të ndërlidhur ngushtë me pabarazitë në punësim, prandaj është më me rëndësi për t'u adresuar.

Një kufizim i madh në lidhje me sfidat strukturore shoqëro-ekonomike për integrim gjinor i cekur nga pjesëmarrësit është perceptimi dominues se gratë janë të mira vetëm si amvise dhe për rritjen e fëmijëve, por jo edhe për të marrë vendime me rëndësi. Për këtë qëllim, institucionet kanë bërë shumë pak dhe nevojitet presioni më i madh nga shoqëria civile për të intensifikuar përpjekjet për barazinë gjinore. Ky anim shoqëror prek në mënyrë negative punësimin e grave pasi që në përgjithësi konsiderohen si gjini më e dobët. Pjesëmarrësit gjithashtu cekin anketa të opinionit publik ku janë të pranishme, në masë të madhe, paragjykimet kundër grave në vendim-marrje. Gratë në pozita vendim-marrëse gjithashtu iu nënshtrohen vështrimit më rigoroz hetues dhe në përgjithësi gabimet e tyre interpretohen si të ndërlidhura me gjininë. Kjo nuk ndodh kur meshkujt në pozita vendim-marrëse bëjnë gabime të natyrës së njëjtë.

Në dobi të punësimit më të madh të grave, posaçërisht në administratën komunale, pjesëmarrësit japin argumente të shumta, në mesin e të cilëve faktin që gratë mund të kryejnë detyra të shumta përnjëherë, nivelin më të madh të sinqeritetit dhe që janë më të vështira për t'u korrupruar në krahasim me meshkujt. Të gjitha këto aspekte konsiderohen si argumente të vlefshme të cilat duhet të përdoren për të avokuar përfaqësim më të madh të grave në zyre publike.

Ngjashëm me Dragashin, pjesëmarrësit e Malishevës gjithashtu nuk kanë njohuri për procesin e integritit në BE dhe si mund të përvilet integrimi gjinor përmes këtij procesi. Diskutimi për këtë temë nxiti diskutimin për kuota, të cilën pjesëmarrësit e konsiderojnë të jetë prezantuar si pjesë e integritit të BE-së dhe propozojnë se duhet të rritet për 50%, duke pasqyruar kështu përqindjen e grave në shoqëri. Sfidat për propozimin e tillë vijnë nga disponueshmëria e kuadrove të grave, prandaj propozimi i tillë është i mundur vetëm në të ardhmen kur të përmirësohet arsimimi i grave. Vlen të ceket se asnjëri nga pjesëmarrësit nuk ishte në gjendje të tregojë hapat e integritit deri në anëtarësimin e plotë dhe as aktivitetet të cilat zhvillohen në secilin prej tyre. Po ashtu, ata në përgjithësi nuk ishin të njoftuar me mjetet në dispozicion për integrim të gjinisë përmes integritit në BE apo financimit në dispozicion për avancimin e agjendës së barazisë.

Pjesëmarrëset në Malishevë gjithashtu vunë në dukje se korniza ligjore zbatohet vetëm pjesërisht. Shqyrtimi funksional i administratës do të kishte ndikim më të madh në lehtësimin e një shkalle më të lartë të zbatimit të legjislacionit të ndërlidhur me gjini. Mungesa e buxheteve të veçanta për promovimin e barazisë gjinore dhe varësia nga institucionet e nivelit qendror për financim përmenden si sfida më të mëdha për integrimin e gjinisë në komunën e Malishevës.

Gjatë diskutimit të rolit të shoqërisë civile në procesin e integritit në BE dhe si katalizator i ndryshimeve në lidhje me integrimin gjinor, pjesëmarrësit mendojnë se shoqëria civile luan një rol me rëndësi, por në të njëjtën kohë, pranojnë se ndikimi nga puna e tyre është i paktë. Shoqëria civile është e marginalizuar dhe ndryshimi i njëmendtë konsiderohet i mundur vetëm përmes politikës dhe partive politike, të cilët përfaqësojnë vendim-marrësit kryesor në Kosovë. Ata e shohin rolin e shoqërisë civile

më shumë si një urë ndërmjet qeverisë dhe komuniteteve, apo si një vëzhgues i qeverisë.

### 3.3. Komuna e Prizrenit

Diskutimi në fokus grupe në Prizren u mbajt më 20 prill 2016, me fillim në ora 10:00, ku ishin të pranishme gjithsej shtatë përfaqësuese të organizatave të grave nga dhjetë sa kishin konfirmuar. Ngjashëm si tek dy komunat tjera, diskutimi në DFG në Prizren gjithashtu filloi me idenë e pjesëmarrësve përkitazi me integrimin gjinor. Në këtë aspekt, pjesëmarrëset konsiderojnë se integrimi gjinor nënkupton përfshirjen e grave në të gjitha lëmitë, por shumica e pjesëmarrësve ishin të mendimit se përfshirja e tillë duhet të jetë e njëmendtë dhe jo arbitrare. Integrimi, sipas mendimit të të anketuarve, duhet të jetë real dhe jo i shprehur në formë të përqindjeve të cilat duhet të përmbushen. Disa pjesëmarrëse sugjeruan se integrimi gjinor mund të jetë më i suksesshëm poqëse meshkujt do të ishin më të vetëdijesuar për barazinë gjinore sepse ata janë ata të cilët duhet të përfshijnë gjininë tjetër.

Përkitazi me sfidat kulturore për arritjen e barazisë gjinore, pjesëmarrëset në DFG vunë në pah shkollimin e grave. Ata e konsiderojnë edukimin si thelbësor për çfarëdo avancimi të pozitës së grave dhe para-kusht themelor për fuqizim të njëmendtë të grave. Martesat e hershme gjithashtu konsiderohet si sfidë serioze për t'u tejkaluar, pasi që janë qartazi të ndërlidhura me shkollimin e grave të reja. Martesat e hershme, përveç që ndërpresin shkollimin e grave të reja para kohe, gjithashtu kushtëzojnë nënshtrimin ndaj bashkëshortëve gjatë gjithë jetës, për shkak të mungesës së mundësive për ata në të ardhmen pa ndonjë shkollim të kryer.

Ndarja e pronës gjithashtu konsiderohet si një prej çështjeve më të rëndësishme për t'u shtjelluar në komunën e Prizrenit. Përderisa pjesëmarrëset në DFG konsiderojnë se gratë në Prizren në përgjithësi janë më të emancipuara dhe kanë filluar t'i kërkojnë të drejtat në pronë, tema, në masë të madhe, mbetet tabu në zonat rurale. Frika nga stigmatizimi nga komuniteti më i gjerë dhe izolimi, si dhe humbja e plotë e mbështetjes nga familja, janë dy mekanizma kryesorë përmes të cilave gratë nënshtrihen dhe detyrohen të heqin dorë nga të drejtat e tyre të trashëgimit të pronës. Hulumtimi në këtë lëmi tregon se shkollimi nuk ndikon në nivelin e trashëgimisë sa mentaliteti apo tradita.

Kur punësimi i grave, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik, gjithashtu konsiderohet si një kufizimi serioz shoqëroro-ekonomik në regjionin e Prizrenit. Pjesëmarrësit në DFG në Prizren dëshmon për diskriminimin e grave në tregun e punës, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Mos respektimi i Ligjit për barazi gjinore shihet si një pengesë më e madhe për t'u tejkualuar në sektorin publik, si dokument themelor që garanton përfaqësimin e grave në institucionet publike.

Në lidhje me punësimin në sektorin privat, përveç standardit të dyfishtë ndërmjet grave dhe meshkujve si dhe pritshmëritë e ndryshme prej tyre, pjesëmarrësit në Prizren konfirmojnë animin gjinor në punë dhe profesione si pengesë madhore. Kjo vështirëson edhe më tej gjendjen e grave, mbi vështirësitë ekzistuese të përshtatshmërisë së mjedisit të punës (gjegjësisht, jo shumë meshkuj) dhe ul gjasat për gjetjen e 'punësimit të përshtatshëm'.

Me ligj, gratë në Kosovë janë të barabartë me meshkujt. Por në praktikë, sipas pjesëmarrësve në DFG në Prizren, në përgjithësi mungon zbatimi i legjislacionit. Një prej problemeve kryesore të cekura në raport me dallimin ndërmjet letrës dhe praktikës është mosndëshkimi për mos zbatim të legjislacionit. Përderisa secili institucion publik bën shkelje të Ligjit për barazi gjinore, nuk ka as edhe një rast i vetëm ku një zyrtar publik është dënua për shkeljet kundër ligjit.

Ngjashëm me Dragashin dhe Malishevën, pjesëmarrësit e Prizrenit gjithashtu shfaqin njohuri të paktë lidhur me procesin e integritit në BE, dhe mënyra të mundshme të shfrytëzimit të procesit për harmonizim të gjinisë. Përkundër kësaj, pjesëmarrëset kanë mundur të vunë në dukje se disa prej kushteve/standardeve të përcaktuara nga BE janë respekti për të drejtat e njeriut, të drejtat e pakicave etnike jo shumicë, si dhe inkorporimi i komponentës gjinore si çështje e ndërthurrur në çdo politikë institucionale.

Diskutimi rreth politikave të BE-së për integrim të gjinisë u sollën rreth çështjes së kuotave, dhe nëse shtetet e BE-së aplikojnë po të njëjtat kuota. Edhe pse shihej si një politikë e imponuar nga Bashkimi Evropian, pjesëmarrëset nuk janë të sigurta se cilat politika sigurojnë integrimin gjinor në nivel komuniteti në BE.

### 3.4. Komuna e Rahovecit

Diskutimi në fokus grupe në Rahovec u mbajt më 18 prill 2016, me fillim në ora 11:30 të paradites, ku ishin të pranishme gjithsej dhjetë përfaqësuese të organizatave të grave nga dhjetë sa kishin konfirmuar. Sipas Udhëzimeve për DFG, diskutimi në Rahovec gjithashtu filloi me nxitjen e ideve dhe mendimeve të partnerëve lidhur me integrimin gjinor si koncept. Në këtë aspekt, pjesëmarrëset në këtë komunë interpretojnë integrimin gjinor si përfshirje e një individi (pavarësisht gjinisë) në të gjitha sferat e jetës. Duke pasur parasysh që popullsia është e ndarë në përafërsisht 50% gra dhe 50% meshkuj, ata duhet të jenë të përfaqësuar në mënyrë të barabartë në të gjitha sferat e jetës. Duhet të ceket se ky ishte një prej definicioneve më gjithëpërfshirëse të dhënë në DFG, pasi që pjesëmarrëset gjithashtu ishin në gjendje të ofrojnë themelet për një qasje të tillë neutrale ndaj gjinisë.

Kur diskutohen faktorët kulturor të cilët ndikojnë tek gratë në mënyrë negative, pjesëmarrëset në DFG në Rahovec sugjerojnë që, si shoqëri civile, duhet të reflektojmë dhe të kuptojmë arsyet e vërteta të diskriminimit të grave në shoqërinë tonë. Edhe pse argumentet e ndërlidhura me moral nuk kanë ndonjë themel të bazuar mbi dëshmi, ato kryesisht bazohen në spekulim dhe paragjykim në bazë të gjinisë. Këta faktorë kulturor ndikojnë në mënyrë negative aspektet të tjera të cilat kushtojnë që roli i grave në shoqëri të jetë i rëndësishëm dytësor. Në këtë kontekst, pjesëmarrëset pohojnë se çështja e arsimit është një prej më të rëndësishmeve që kërkon adresim. Duke qenë se shkollimi është mënyra më e mirë për të luftuar mentalitetin e prapambetur, shkollimi është edhe kontributi më i drejtpërdrejt në punësimin e grave dhe fuqizimin ekonomik.

Një aspekt që vihet në pah në DFG në Rahovec është mungesa e përgjithshme e mbështetjes nga gratë për gratë. Mungesa e mbështetjes së përgjithshme të grave ndaj grave udhëheqëse, grave në politikë, biznes apo në çfarëdo pozitë tjetër udhëheqëse, dëshmon një anim mjaft domethënës (madje edhe në mesin e grave) se gratë nuk qenqëshin të kualifikuar për të ushtruar disa funksione apo punë të caktuara. Nevoja për solidaritet dhe mbështetje reciproke në mesin e grave shihet si një pjesë e rëndësishme në drejtim të fuqizimit të grave.



Në lidhje me gratë në politikë dhe poste të zgjedhura, pjesëmarrësit në DFG shohin një problem të dyfishtë, pasi që përveç mungesës së mbështetjes së grave për gratë, gratë e zgjedhura gjithashtu shumë rrallë përpiqet t'i përfaqësojnë interesat e grave. Kjo, sipas mendimit të pjesëmarrësve, ka distancuar edhe më shumë elektoratin e grave.

Për nga pengesa strukturore shoqërore dhe ekonomike të cilat duhet të tejkalohen, të anketuarit në Rahovec gjithashtu vunë në pah diskriminimin në trashëgimi si aspekt i parë që kërkon vëmendje imediate. Diskutimi lidhur me temën e trashëgimisë, përveç rrafshit kulturor, gjithashtu preku edhe aspektet ekonomike dhe politike të çështjes. Në këtë aspekt, nga këndvështrimi ligjor, pjesëmarrëset besojnë se legjislacioni duhet të ndryshohet në mënyrë që të eliminohet mundësia e heqjes dorë nga trashëgimi si një opSION për gratë gjatë ndarjes së pronës. Edhe pse asnjë ligj nuk mund t'u ndalojë që ta japin pronën si dhuratë vëllezërve të tyre, kjo do të përmirësonte dukshëm gjendjen pasi që do të zvogëlohej presioni tek gratë gjatë ndarjes së pronës dhe do të ulte parregullsitë me të cilat shpesh shoqërohen proceset e ndarjes.

Nga këndvështrimi shoqëror, pjesëmarrëset mendojnë se problemi i trashëgimisë gjendet përbrenda sferës së familjes dhe ndarja e bazuar në gjini e roleve dhe përgjegjësi brenda familjes dhe shoqërisë në përgjithësi. Mirëpo, kjo gjendje e kushtëzuar shoqërore ka efekt ekonomik tek gratë dhe është një pengesë më e madhe për fuqizimin e grave. Kufizon qasjen në financa, siguri ekonomike dhe ndikon drejtpërsëdrejti në rolet e bashkëshortëve në një çift. Intervenimet për të ofruar stimulime më të mëdha për ndarjen e drejtë ndërmjet fëmijëve meshkuj dhe femra është ofrimi i sigurisë financiare për të moshuarit, pasi që vetëm atëherë prindërit mund t'u ndajnë pasurinë fëmijëve në mënyrë të barabartë pa drojë të kujdesit për ata në moshë të shtyrë.

Pjesëmarrësit në Rahovec pohojnë se infrastrukture ligjore në Kosovë lidhur me barazinë gjinore mund të krahasohet me atë të vendeve të zhvilluara perëndimore, mirëpo problemi është se zbatimi i këtyre ligjeve në praktikë mbetet shqetësues. Pjesëmarrëset besojnë se të arriturat ekzistuese në integrimin gjinor gjithmonë kanë ardhë si rezultat e presioneve të jashtme, dhe jo si një nevojë e pranuar për adresimin e këtyre prioritetëve.

Pjesëmarrëset në Rahovec shfaqën dije shumë të paktë lidhur me procesin e integrimit në BE dhe mundësitë që ai ofron për integrimin gjinor. Një prej aspekteve të parashtruar në DFG në Rahovec është procesi jo i drejtë i punësimit në administratën publike, i cili, në shumicën e rasteve bëhet sipas vijave partiake. Proceset e tilla ndikojnë tek gratë në mënyrë negative, sepse roli i saj brenda partive politike është mjaft i marginalizuar. Punësimi jo i drejtë gjithashtu pengon që gratë e kualifikuara të kyçen me sukses në poste të profilit të lartë në administratën publike.

Njohuritë e pakta lidhur me vetë procesin e integrimit në BE janë pengesë reale pasi që u pengon grave dhe organizatave të grave ta shfrytëzojnë në mënyrë efektive procesin e avancimit të agjendës së barazisë gjinore. Proces, si i tillë, është i dizajnuar ashtu të vendi të përvetësojë politika varësisht prej realitetit në terren, me synim të përcaktimit të përputhshmërisë/standardeve minimale për tërë bashkimin. Nëse hisedarët kryesorë nuk janë të pajisur me dijen e nevojshme mbi procesin, ndryshimi që sjell procesi i integrimit gjinor do të jetë i paktë.

### 3.5. Komuna e Suharekës

Diskutimi në fokus grupe në Suhareke mbajt më 19 prill 2016, me fillim në ora 10:00, ku ishin të pranishme gjithsej dhjetë përfaqësuese të organizatave të grave nga dhjetë sa kishin konfirmuar. Këndvështrimet dhe mendimet e pjesëmarrësve në DFG në Suhareke janë mjaft të ngjashme me komunat tjera në regjionin e Prizrenit. Pjesëmarrëset shfaqën dije elementare për integrimin gjinor por nuk e kuptojnë thelbin e qasjes dhe si aplikohet në praktikë. Në këtë aspekt, përkufizimi i ofruar nga pjesëmarrësit në lidhje me atë se çka është integrimi gjinor ishte niveli i lartë i pjesëmarrjes së grave në të gjitha aspektet e jetës dhe pozitive vendim-marrëse.

Diskutimi lidhur me pengesat kulturore për fuqizimin e grave dhe arritjen e një barazie më të madhe ishin mjaft të ngjashme me diskutimet në komunat tjera. Sfidat e parë për integrim gjinor dhe barazi të plotë gjinore, sipas mendimit të pjesëmarrësve në Suhareke, vjen nga mentaliteti i prapambetur. Edhe pse në qytetin e Suharekës është shënuar një përparim i dukshëm në lidhje me punësimin e grave, në zonat rurale, mbesin sfida domethënëse. Pjesëmarrëset e DFG në Suhareke vunë në pah se mentaliteti

është një pengesë shumë e vështirë për t'u tejkaluar pasi që ndryshimi i tij kërkon kohë. Tërësitë e vlerave dhe normat të cilat përbëjnë standardin shoqëror të sjelljes janë të rrënjosura thellë në personalitetin e njerëzve, pasi që shumica e tyre krijohen herët në jetë. Krijimi i tyre fillon në familje, por formësohet më tej nga sistemi arsimor dhe shoqërimi jashtë familjes. Në të dyja këto mjedisre, mbizotëron edhe më tej mentali i prapambetur, duke vështirësuar çfarëdo ndryshimi.

Pabarazia në arsim gjithashtu konsiderohet si një pengesë për integrimin gjinor. Diskriminimi në arsim kundër vajzave, posaçërisht në zona rurale, të cilat shpesh arsyetohen me moralin e familjes, ka bërë që tratë të vuajnë nga diskriminimi gjatë tërë jetës. Duke qenë se nuk mund të gjejnë punë, ata varen nga të hyrat prej familjeve të tyre (bashkëshortët), duke marginalizuar kështu rolin e tyre përbrenda domenit të familjes.

Çështja e trashëgimisë së pronës doli në sipërfaqe si një prej pengesave më të mëdha dhe ndër të parat kundrejt integritit gjinor. Aplikimi aktual i të drejtës zakonore (në kuadër të domenit të ligjit të shkruar) për dallim nga ndarja e pronës pavarësisht gjinisë, vazhdon ciklin e diskriminimit kundër grave dhe trajtimin jo të drejtë që marrin nga shoqëria. Pjesëmarrëset vunë në pah vështirës lidhur me zbatimin e ligjeve aktuale në fuqi për trashëgimi në zonat rurale.

Sundimi i ligjit shfaqet si një prej aspekteve kyçe/komponentave të integritit në BE si dhe nevoja për reforma më intenzive me synim përshtetshmëri të procesit të anëtarësimit. Infrastruktura ligjore konsiderohet si shumë e mirë ku pjesa më e madhe e ligjeve u harmonizuar me ligjet e Bashkimit Evropian. Procesi i reformimit sipas mendimit të pjesëmarrës në DFG duhet gjithashtu të ngërthejë dizajnimin për modele më efektive të zbatimit.

Pjesëmarrëset në DFG në Suharekë duket se posedojnë njëfarë njohurie lidhur me mjetet dhe politikat për integrim të gjinisë në nivel të BE-së, por njohuria kufizohet vetëm në njohuri të politikave për trajtim të barabartë dhe jo masave specifike dhe burimeve për avancimin e pozitës së grave.

Vrojtimit e fundit në diskutim u parashtruan për rolin specifike të shoqërisë civile në procesin e integrimit në BE dhe si ky proces mund të përshtatet për të avancuar agjendën e barazisë gjinore. Pjesëmarrëset në grupe pohuan se OSHC-të në Suharekë pasqyrojnë prioritetet e grupeve përbërëse të tyre dhe gëzojnë mbështetjen e popullsisë. OSHC mbështesin nisma të grave të cilat kërkojnë të drejta pronësore dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës familjare. Mirëpo, roli i shoqërisë civile mbetet shumë më i gjerë dhe ngërthen edhe aktivitete vëzhguese dhe vlerësimin hetues të qeverisë, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal.

## 4. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

**B**azuar në diskutimin e lartcekur dhe në përputhje me pikësynimet e parashtruar për këtë hulumtim, ekipi i hulumtimit dëshiron të nxjerr rekomandimet vijuese dhe ofrojë disa vrojtime të fundit për adresimin e tyre. Vrojtmet ofrohen për secilën prej temave të shtjelluara.

Ngritja e vetësjes e OSHC-ve dhe e publikut në përgjithësi për integrimin gjinor shihet si i domosdoshëm. Kalimi nga një qasje ndarëse në atë integruese, e paraparë për integrimin e gjinisë në tërë sektorin paraqet një kalim të cilën shumë pjesëmarrës në DFG ende nuk e kanë paraqitur. Si bartës kryesor të detyrave, ata duhet të mbështeten në dijen dhe të kuptuarit e integritit gjinor për të avancuar gjendjen e grave në komunitetet e tyre përkatëse. Në lidhje me pengesat dhe sfidat e barazisë gjinore, pjesëmarrësit në DFG në regjionin e Prizrenit i cekin të drejtat në trashëgimi si një prej çështjeve më të rëndësishme për t'u shtjelluar. Ka ndikim direkt në barazinë e grave dhe meshkujve, si nga aspekti shoqëror ashtu edhe nga ai ekonomik. Për këtë qëllim, janë dhënë rekomandime për të ndryshuar legjislacionin për trashëgimi, të eliminohet tërësisht mundësia e heqjes dorë nga trashëgimia, e cila aktualisht zbatohet nga shumica e grave të cilat kalojnë nëpër procesin e ndarjes së pronave. Ndryshimi i tillë ligjor do të kishte ndikim të drejtpërdrejt në fuqizimin e grave, pasi që nga këndvështrimi ligjor, akti është i kthyeshëm, ndërsa akti i heqjes dorë nga drejta në trashëgimi nuk është. Për ta adresuar këtë mangësi, nevojitet edhe një vetëdije më e lartë në mesin e çifteve të reja, por edhe në mesin e përfaqësuesve të gjyqësorit.

Shkollimi gjithashtu konsiderohet si një pengesë madhore për barazinë gjinore. Me shkathtësi dhe dituri të kufizuara, gratë nuk ia dalin të gjejnë punësim dhe shpesh kufizohen vetëm në rolin e amvisës. Përveç fuqizimit ekonomik, konsiderohet se arsimimi gjithashtu sjell fuqizimin shoqëror dhe

ka ndikim pozitiv edhe në ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e integrimit. Shkollimi joformal i pranuar në shtëpi, gjithashtu është një rol i rëndësishëm i procesit të socializimit, dhe prandaj edhe kërkon vëmendje mjaft të madhe.

Animi gjinor në profesione dhe standardet e dyfishta dhe normat për qëndrueshmërinë e tyre për meshkujt dhe gratë janë aspekte më problematike për t'u adresuar në lëminë e punësimit. Kjo vlen posaçërisht për sektorin privat, ku gratë shumë rrallë kërkojnë punësim. Në anën tjetër, në sektorin publik në anën tjetër, zbatimi më efektiv i Ligjit për barazi gjinore është vetëm skenar i zbatuar për angazhim më të madh të grave.

Nevojitet hartimi i doracakëve dhe shabllonëve si dhe realizimi i një hulumtimi pilot lidhur me buxhetimin gjinor në mënyrë që të ofrojë një storie suksesi të cilin do ta pasojnë të tjerët. Kjo në përgjithësi u dakordua nga të gjithë pjesëmarrësit dhe rekomandimet e tilla bazohen kryesisht në mungesën e burimeve njerëzore nëpër institucione në mënyrë që ata vetë t'i realizojnë proceset e tilla. Gjithashtu nevojitet zhvillimi i kapaciteteve të OSHC-ve dhe zyrtarëve komunal lidhur me procesin e integrimit. Duket se ekzistojnë njohuri të pakta nga pjesëmarrësit lidhur në DFG, posaçërisht për mekanizmat për integrim gjinor përmes procesit të integrimit. Vetëm pasi të jenë pajisur me dije dhe shkathtësi adekuate për këtë temë ata mund t'i ushtrojnë rolet e tyre në proces në mënyrë efektive dhe të arrijnë rezultate të qëndrueshme lidhur me barazinë gjinore dhe integrimin gjinor në të gjitha sektorët.

## SHTOJCË

### *Udhëzimet për DFG*

- 1) Çka nënkuptoni me integrim gjinor?
- 2) Cilat janë sfidat kulturore për integrim gjinor?
- 3) Cilat janë sfidat strukturore social-ekonomike për integrim gjinor?
- 4) Cilat janë kriteret për anëtarim në BE?
- 5) Cilat janë fazat për anëtarim në BE?
- 6) Si e ka rregulluar Kosova infrastrukturën ligjore për barazi gjinore?
- 7) Sa implementohen?
- 8) Pse ka ngec, kush është shkaktar?
- 9) Si e ka rregulluar BE bazën ligjore për barazi gjinore?
- 10) A e dini se çfarë është baza ligjore për barazi gjinore në nivel të BE?
- 11) Çka është "Acquis Communautaire"?
- 12) A jeni të njohur për direktivat në nivel të BE?
- 13) Çfarë roli mund/ duhet të luajë shoqëria civile në procesin e integritit në BE?
- 14) A e dini cilat janë mekanizmat që BE përdor për përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e integritit gjinor?



An EU funded project managed by the  
European Union Office in Kosovo



Kvinnor till Kvinnor

[www.kgscenter.net](http://www.kgscenter.net)